



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ELIDA TAKE
ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE
NR. 5, RR. TISH DAIJA, GODINA NR.
9, NJESIA 1, HYRJA 1
TEL: 0698885621

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(AKSIONE)

Nr. repertori: 162

Nr. koleksioni: 91

Tirane më 14/02/2025

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 124/2024, datë 19/12/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2025053770009352804



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

NR. 162. REP
NR. 21. KOL

KONTRATË SHITBLERJE
KUOTASH KAPITALI

Sot më datë 14.02. 2025 (dymijë e njëzet e pesë), para meje noterit publik, Elida H. TAKE, anëtar i Dhomës së Noterëve Tiranë, në zyrën time noteriale të ndodhur në Tiranë Rruga Medar Shtylla, kompleksi Kika u paraqitën personalisht palët kontraktuese të cilët më kërkuan hartimin e kësaj kontrate në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë", ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar), ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i ndryshuar) dhe statutit të shoqërisë "New fragen by Intermedica" Sh.p.k me kushtet e mëposhtme:

I. PALËT

Pala Shitëse: Shoqëria Intermedica Center shpk, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) me datë 13.03.2003, me Nipt K31513084W me qëndër në Tiranë, në adresën Rruga Jordan Misja, (referuar ekstrakt të QKB) shoqeri e cila paraqitet në këtë kontratë në cilësinë e ortakut zotërues 45% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "**New Fragen by Intermedica**" shpk.

Pala Blerëse: Z. Gert Reka, i datëlindjes 10.03.1985, i biri i Abedin Reka, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, në adresën Durrës, (sipas deklaratimit të tij), madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës letërnjoftimin (ID) me numër personal I50310072W.

Kushtet Paraprake

- Shoqëria "**New Fragen by Intermedica**" shpk, I regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) me Certifikatë Regjistrimi (NIPT) M22017502L, me zyrë qendrore në Durrës me kapital të regjistruar 10,000 (dhjete mijë) lekë; me ortakë Shoqëria Intermedica Center shpk zotërues i 1 (një) kuote, e cila përbën 45% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe Gert Reka zotërues i 55% të kapitalit të shoqërisë; me administrator z Gert Reka.
- Pala shitëse është e interesuar të shesë kuotën që ai zotëron në shoqërisë "**New Fragen by Intermedica**" shpk dhe pala blerëse është e interesuar të blejë këtë kuotë;

Për sa më lart palët bien dakord, për sa vijon:



II. OBJEKTI

2.1 Nëpërmjet kësaj kontrate pala shitëse Shoqëria Intermedica Center shpk i shet palës blerëse dhe konkterisht z Gert Reka, 1 kuotë = 45% të kapitalit që zotëron në shoqërinë "New Fragen by Intermedica" shpk.

2.2 Pas regjistrimit të kësaj kontrate në Qendrën Kombëtare të Biznesit, ortakët e shoqërisë "New Fragen by Intermedica" shpk do të jenë z Gert Reka zotërues i 1 (një) kuote i cili përfaqëson 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "New Fragen by Intermedica" shpk, pra ortak i vetëm do të jetë z Gert Reka.

III. ÇMIMI

3.1 Palët bien dakord që çmimi i shitjes së kuotës, objekt i kësaj kontrate, është 4,500 (kater mijë e peseqind) lekë. Çmimi i kontratës do të likuidohet nga pala blerëse në masën 4 500 (kater mijë e peseqind) lekë nga Gert Reka direkt në llogarinë bankare të komunikuar nga pala shitëse Shoqëria Intermedica Center shpk, brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kësaj kontrate.

3.2 Për çdo vonesë në pagesën e çmimit, do të aplikohet një interes në masën 10% në vit.

IV. TË DREJTA DHE DETYRIME TË PALËVE

4.1 Pala blerëse dhe/ose personat e caktuar prej saj ka/në të drejtë të ketë akses në të gjithë dokumentacionin juridik, financiar e teknik të shoqërisë "New Fragen by Intermedica" shpk.

4.2 Pala blerëse detyrohet të paguajë çmimin e kontratës, brenda afatit të përcaktuar në pikën 3.1 të kësaj kontrate.

V. KALIMI I PRONËSISË

5.1 Palët kanë rënë dakord që kjo kontratë shitblerje kuotash kapitali, të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), menjëherë pas nënshkrimit të saj dhe z. Gert Reka do të bëhet ortak i shoqërisë "New Fragen by Intermedica" shpk, duke zotëruar 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

5.2 Nga momenti i regjistrimit të kësaj kontrate në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) pala shitëse, humbet çdo të drejtë pronësie mbi kuotën që ai ka në shoqërinë "New Fragen by Intermedica" shpk.

Kjo Kontrate hartohet në 5(pese) kopje origjinale ne gjuhen shqipe.

PALA SHITËSE

Basim Hajri
[Signature]

PALA BLERËSE

GERT REKA

NOTER

Elvira H. Gaska
[Signature]

[Signature]